



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 125

Prishtinë, më 17.9.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 11.9.2013,
3. Shqyrtimi i projektligjit për fshatin Zymi i Hasit,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, me një shtesë rreth kërkesës për vizitën në Kroaci prej datës 22 shtator.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.9.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11.9.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Zymin e Hasit

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të ftuarit nga Këshilli trashëgimor dhe konstatoi se nga Instituti i Prizrenit nuk janë përgjigjur ftesës për mbledhjen e sotme. Ai shtoi se ky projekt nuk ka ngjashmëri me dy ligjet e miratuara në Kuvend për Hoqën dhe Prizrenin ngase është hartuar për të mbrojtur trashëgiminë tonë të çmuar. Para se të filloi komisioni shqyrtimin nen për nen, kryetari hapi diskutimin.

Liburn Aliu kundërshtoi projektin në disa aspekte, fillimisht sa i përket termit ZVM (zonë e veçantë e mbrojtur) ngase nuk duhet të jetë me këtë trajtim. Në fakt ky fshat duhet të jetë ZM (zonë e mbrojtur) për të cilin duhet të angazhohemi për mbrojtjen e vlerave trashëgimore dhe kulturore. Sipas tij termi ZVM fillin e ka tek pakoja e Ahtisarit dhe raporti i Kai Aides i cili pat konstatua se kishat rrezikohen nga shqiptarizmi, çka do të thotë se gabim i rëndë është të inkorporohemi në këtë shqyrtim me konstatimin racist dhe me akuzën ndaj shqiptarëve se po i rrezikojshin kishat, ndërsa tani ky formulim tek ky projekt për Zymin bartet me një formulim tjetër “shqiptarët mysliman” (pasi nuk ka të bëjë ky fshat me serb), kjo është arsyeja kryesore pse e kundërshton ligjin, përfundoi. Në anën tjetër ai shtoi se trazirat e vitit 2004 nuk mund të cilësohen si “trazira fetare”, gjithashtu këtë ZVM nuk kanë konstatuar ekspertët përkatës të tanishëm për trashëgimi kulturore por ekspertët e thjeshtë të gjeodezisë, sipas dokumenteve që kanë pas vlerë para 20 apo 30 vitesh. **Gjejlane Hoxha** gjithashtu konstatoi se ligjet për zonat e veçanta kanë mbetur “të vjerrun”, ngase për të mbrojtur një zonë, së pari duhet të shpallet sipërfaqe e mbrojtur. **Faik Koci** nga këshilli u ndërlidh në diskutim rreth përkufizimit të kufijve duke marr shembull Butrintin. **Daut Haradinaj** sqaroi se ky ligj e ka qëllimin të gjej formën si të mbrohet territori i caktuar, prandaj nuk dëshiroj të polemizoj rreth kërkesës së Liburn Aliut pse duhet të shpallet ZM sepse gjatë hartimit ka pas presion të hiqet termi ZVM, ndaj shprehu habinë pse edhe këtu kërkohet e njëjta gjë. **Liburn Aliu** përsëriti arsyet e lartcekura dhe tha që të shpalosen tani presionet që ceken nga z. Haradinaj, ngase në njëfarë mënyre si tha ai “dalim naiv nëse i mbyllim sytë para këtyre gjërave”. Për termin KZM (këshilli zbatues dhe monitorues) tha se ne tani po mundohemi ta zbusim, mirëpo **Daut Haradinaj** tha se e ka cekur këtë term si domosdoshmëri momentale i cili më vonë do të hiqet në tërësi. **Nijazi Idrizi** u bashkëngjit me konstatimin se dy ligjet e miratuara më herët kanë pas vlerë për monumentet serbe, por tani me këtë ligj kemi zonë shqiptare të cilin duhet me mbrojt deri në fund, përkrahu sponzorizuesin z. Haradinaj. **Liburn Aliu** mori një shembull : ne kemi ndërtua një objekt të keq ndërsa tani po themi hajde ti biejmë mallterë për të hequr të keqen që ka, çka nuk bënë. Reagimi që duhet të bëjmë është ti shkojmë punës me korrektësi dhe të lëmë rrugën e hapur për definim të drejtë, ngase termi ZVM vetëm sa i mjegullon gjërat. Kërkoi të sqarohet autori i vërejtjeve nga OSCE ose të ftohet në mbledhje.

Nait Hasani sugjeroi referimin në dy ligjet e miratuara për planifikim hapësinor dhe trashëgimi kulturore, ndërsa në vazhdim ftoi komisionin për shqyrtim nen për nen të projektligjit, i cili u përmbyll me Nenin 5, ndërsa do të vazhdoi shqyrtimi të premtën në orën 11,00.

Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin për vizitën në Kroaci që do të duhej të realizohet më 22 shtator me alternativën 5+1. Detalet do të sqarohen në vijim deri të premtën, rreth vizave dhe rreth emrave të delegacionit.

Pasi që shqyrtimi i **Projektligjit për Inspektoratet** në komisionet e përhershme ka përfunduar, komisioni konfirmoi të njëjtën për leximin e dytë pa ndonjë vërejtje shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

